



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË**

VENDIM

Nr 22 Datë 01.04. 2009

**Mbi pranimin e dhurimit të mjetit Eskavator nga UKKO sh.a në pronësi të
Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Korçë**

Këshilli i Bashkisë së qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, dhe bazuar në Ligjin nr. 8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", neni 32 dhe 8, pika 1,II, gërma "a" dhe "c" dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 772-783

VENDOSI :

1. Të pranojë dhurimin e mjetit Eskavator, tipi Fiorenti F 675, me Nr. Shasie 40095, ngjyra e verdhë, me karakteristika teknike : Lënda djegëse- naftë, Vëllimi 0.7 m3, Viti i prodhimit 1990, Motor Perkins S.P.A me 6 pistona, pranë strukturave të qeverisjes vendore, në funksion të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.
2. Të autorizojë Drejtorin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Z.Artan Loci për nënshkrimin e kontratës së dhurimit me akt noterial.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi me njëherë.

KRYETARE E KESHILLIT BASHKIAK

RAIMONDA NASE

Raimonda Nase